



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 05 datë 25.06.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “STRUKTURË
HOTELERI DHE SHËRBIME “NALT HOTEL”, ME 9 DHE 10 KATE MBI TOKË
DHE 1 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SHKODËR

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Dbh Construction” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:


1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë hoteleri dhe shërbime “Nalt Hotel”, me 9 dhe 10 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër, me subjekt zhvillues shoqërinë “Dbh Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAIDA ROKA



Nënshkruar më datë 13/05 2026